

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Auditim
(zgjidhjet)

P6

Data 30/09/2017

Detyra 1

Klienti juaj, Diella Shpk është kompani për prodhimin e pajisjeve për lodra në parqe dhe shkolla. Kompania Diella është themeluar para pesë vitesh dhe kishte marr grante qeveritare për të mbuluar koston e punësisimit dhe koston kapitale për pajisje. Numri i punonjësve të kompanisë vazhdon të rritet nga 15 punonjës sa kishte në fillim.

Si auditor të jashtëm të Diella Shpk, qasja e firmës tuaj të auditimit ishte të kryenit një auditim të ndërmjetëm dhjetë muaj pas fillimit të vitit fiskal dhe pastaj të kryeni auditimin përfundimtar i cili në përgjithësi fillon gjashtë javë pas përfundimit të vitit fiskal. Ju sapo jeni avancuar në pozitën e seniorit të auditimit dhe jeni duke rishikuar dosjet e auditimit të cilat ishin përgatitur gjatë vizitës për auditimin e ndërmjetëm të Diella Shpk.

Jeni takuar me menaxherin e auditimit për të këtë angazhim dhe ai ju ka treguar se nga puna e kryer gjatë auditimit të ndërmjetëm në fushën e procesimit të pagave dhe sistemit të kontabilizimit të pagave, sistemet nuk përmbajnë kontrole të mjaftueshme të cilat do të duhej të ekzistonin sikur në kompani tjera të ngjashme. Shënimet e menaxherit të auditimit janë të paraqitura më poshtë:

“Diella ka një numër të listave të pagave, prej të cilave më e madhja është lista e pagave të prodhimit e cila ka përafërsisht 40 të punësuar. Punonjësit në prodhim paguhen me pagë standarde javore për 35 orë pune. Mirëpo, shumica e punonjësve punojnë jashtë orarit gjë që ndikon në rritje të konsiderueshme të pagës javore.

Të gjithë punonjësve në prodhim u kërkohet të shënojnë orët e punuara në bazë ditore. Punonjësit regjistrojnë kohën përmes kartelave në pajisjet që gjenden në të gjithë fabrikën. Mbikqyrësit e prodhimit i ofrojnë departamentit të burimeve njerëzore informata për punonjësit që janë në pushim, informatë e cila përdoret të krahasohen punonjësit që janë regjistruar në pajisje kundrejt numrit total të punonjësve të prodhimit. Çfardo mospërputhje duhet të ndiqet dhe hetohet. Mirëpo ky krahasim nuk ishte kryer për disa muaj për shkak të ngarkesës me punë në departamentin e burimeve njerëzore si dhe mosdorëzimit të raporteve me kohë nga mbikqyrësit e prodhimit. Përveç kësaj, të gjithë të punësuarit plotësojnë listat e orëve të punës çdo javë në të cilat regjistrohen orët standarde dhe puna jashtë orarit.

Këto lista pastaj dërgohen në departamentin e burimeve njerëzore ku futen manualisht në sistemin e procesimit të pagave. Nëse nuk pranohet ndonjë listë e orëve të punuara, sistemi automatikisht gjeneron dhe llogarit orët standarde të punës për atë punonjës.

Pastaj sistemi llogarit dhe prodhon listën e përgjithshme të pagave dhe krijon fletëpagesat individuale të pagave. Këto fletëpagesa dorëzohen te mbikqyrësit e prodhimit që i shpërndajnë te punonjësit. Sistemi i pagave është i integruar me sistemin e kontabilitetit/financiar dhe automatikisht regjistron shpenzimin e pagave të ndarë në mes të shpenzimeve të prodhimit dhe të tjera si dhe ngarkon llogarinë e detyrimeve për paga neto, tatime dhe pensione. Saldoja e llogarisë së pagave të pagueshme ngarkohet si shpenzim në baza tremujore.

Nuk ka raporte të prodhuara në letër nga sistemi i pagave.

Programi i pagave përdorë orët e futura nga punonjësit si dhe informatat tjera nga dosja kryesore për të llogaritur pagat. Dosja kryesore azhurnohet rregullisht me informatat për punonjësit e ri, ndryshimet në tatime ose pensione, ndryshime në norma të pagave, etj. Këto ndryshime akumulohen çdo javë dhe përpunohen nga punonjësit e departamentit të pagave. Ndryshimet stampohen në formë elektronike dhe ruhen me fjalëkalim dhe emër të përdoruesit. Ky fjalëkalim dhe emri i përdoruesit është i njëjtë për të gjithë të punësuarit në departamentin e pagave.

Kompania ka një llogari të veçantë bankare për pagesën e pagave në të cilën depozitohet shuma bruto javore e pagave nga llogaria kryesore.

Të gjitha pagesat që lidhen me pagat bëhen nga kjo llogari e veçantë bankare.

Çfarëdo shume e mbetur për tatimet e pagueshme ose të tjera shlyhet në fund të vitit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Çfarëdo shume e papaguar e pagave kthehet në llogarinë kryesore.”

Kërkohet:

(a) Ju jeni senior i auditimit dhe është kërkuar nga ju të përgatitni një raport për menaxherin e auditimit bazuar në shënimet e mësipërme. Raporti juaj duhet të përmbajë aspekte të cilat sipas jush ndikojnë në dobësi të kontrollit lidhur me sistemin e procesimit të pagave dhe kontabilizimit të pagave. Gjithashtu ofroni rekomandime për përmirësimin e dobësive të identifikuara. (14 pikë)

(b) Diella Shpk mban një llogari të veçantë bankare për shpenzimet e pagave. Çfarë përparësi ka përdorimi i një sistemi të tillë? (6 pikë)

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja

(a)

(i) Kontrolli i listave të orëve të punuara/saktësia e të dhënave në listat e pagave

Kontrolli i dobët lidhur me listat e orëve/nënshkrimeve:

- Duket se nuk ka procedura të ndjekjes lidhur me listat që nuk janë pranuar.
- Procedura për harmonizimin e listave të orëve të punuara dhe informatave nga regjistrimi elektronik i orëve të punuara nga punëtorët me përmbledhjen e kohës së regjistruar dhe numrit të punonjësve nuk është i formalizuar dhe nuk përfundohet me kohë – nuk ka procedura të ndjekjes së mospërputhjeve të mundshme.
- Nuk ka procedura për aprovimin e listave të orëve të punuara nga mbikqyrësit.

Rekomandimi: të gjithë mbikqyrësit të nënshkruajnë listat e orëve për të aprovuar punën jashtë orarit dhe orët e zakonshme të punuara në mënyrë që pagat të mund të harmonizohen me regjistra.

(ii) Sistemi i prodhimit – llogaria e detyrimit të pagave

Saldo në këtë llogari shpenzohet në bazë tremujore pa u hetuar me tutje.

Dështimi për të hetuar natyrën e saldos mund të rezultojë me çështjet në vijim:

- Pagesa e pagave bazuar në informata të pasakta.
- Variancat mund të regjistrohen në mënyrë të pasakt.

(iii) Kontrollimi i validimit të të dhënave hyrëse

Duket se nuk ka procedura specifike për të siguruar saktësinë e listave të orëve të punuara.

(iv) Kontrollat logjike mbi qasje

Kontrollat logjike mbi qasje janë të dobëta pasi që i tërë departamenti i burimeve njerëzore përdor të njëjtin emër të përdoruesit dhe fjalëkalim.

Rekomandimi: secili punonjës duhet të ketë emër dhe fjalëkalim unik i cili duhet të ndryshohet në bazë të rregullt.

(v) Ndryshimet në dosjen kryesore të të punësuarve

Ndryshimet në dosjen kryesore të të punësuarve hetohen vetëm nëse ka ndryshime në të punësuar. Mirëpo kjo dosje duhet të hetohet në baza të rregullta edhe nëse nuk ka pasur ndryshime. Duhet të prodhohet një dokument i shkruar i cili do të shtypet dhe nënshkruhet për tu aprovuar nga niveli i duhur i menaxhmentit. Kjo është sidomos e rëndësishme pasi që kontrolli në qasje është i dobët.

(vi) Llogaria bankare e pagave

Gjendja e mbetur transferohet në llogarinë kryesore.

Nuk duhet të ketë gjendje të mbetur pasi që kjo llogari mbushet bazuar në paga javore. Mirëpo, gjendjet e mbetura mund të rezultojnë në rrethanat në vijim:

- Ndonjë pagë nuk është paguar me urdhërpagesë
- Urdhërpagesat e lëshuara nuk përputhen me llogaritjet e bëra nga departamenti i burimeve njerëzore.

Natyra e e kësaj llogarie duhet të hetohet dhe të zgjidhet në baza të rregullta (dmth mujore/tremujore).

Rezultatet e këtij hetimi duhet të raportohen direkt te kontabilisti.

(vii) Llogari të ndryshme të ndalesave

Saldot e mbetura për ndalesave të ndryshme shlyhen si pjesë e procesit të përgatitjes së pasqyrave financiare çdo vit.

Natyra e e kësaj llogarie duhet të hetohet dhe të zgjidhet në baza të rregullta (dmth mujore/tremujore).

(b) Mbajtja e një llogarie të veçantë bankare është procedurë e zakonshme e kontrollit në të cilën hasin auditorët.

Kjo llogari e veçantë:

- Lejon zbatim më të lehtë të procedurave të kontrollit siç janë testet e limiteve dhe kontrollet e validitetit;
- Operon si një masë e sigurisë. Duke lënë anash një sasi të mjaftueshme të parave, kompania mbikqyrë shpenzimet e limituara vetëm për atë qëllim;
- Lejon kontroll shtesë për urdhërpagesat e porealizuara;
- Ndhmon funksionin e auditimit për të kontrolluar më lehtë llogaritë e pagave;
- Kufizon shumat e parasë të mund të jenë object i vjedhjes;
- Ndhmon në harmonizimin e llogarisë bankare.

Detyra 2

(a) Konsideroni situatat materiale që janë paraqitur gjatë punës së auditimit në tri kompani të ndryshme. Secila situatë është materiale.

Kërkohe:

Diskutoni çfarë hapa shtesë duhet të merr Auditori në secilin rast të veçantë bazuar në informatat e dhëna në pyetjet e mëposhtme, përfshini edhe llojin e opinionit të auditorit që ju mendoni ta jepni si rezultat i tri situatave më poshtë.

(i) Jeni duke e finalizuar auditimin e Arilena SHA dhe e keni vërejtur se në raportin vjetor (që i bashkëngjitet pasqyrave financiare) nga drejtori, fitimi neto është paraqitur në vlerë prej €1,000,000, krahasuar me €500,000 në paqyrën e të ardhurave. Nga diskutimi me menaxhmentin, ju keni zbuluar se ndryshimi është rezultat i mospajtit nga menaxhmenti të korrigoj provizionet për borxhet e dyshimta. Ju besoni se shifra në pasqyrën e të ardhurave është paraqitur drejtë. **(4 pikë)**

(ii) Jeni duke e finalizuar auditimin e Haziri SHA dhe keni vërejtur se kompania është në mosmarrëveshje me bankën, e cila kishte kërkuar kthimin e plotë të kredisë brenda gjashtë muajve të ardhshëm. Haziri SHA nuk do të ketë mundësi të përmbushë këtë obligim pa përfutur ndonjë financim tjetër. Edhe pse negociatat me një institucion tjetër financiar për rifinancim janë duke ecur mirë, ende nuk është arritur ndonjë marrëveshje për kredi. Kjo pasiguri lidhur me kredinë është shpallur në mënyrë të mjaftueshme në pasqyrat financiare të kompanisë. **(7 pikë)**

(iii) Si pjesë e auditimit të Goni SHA, ju keni marrë pjesë në numërimin e stoqeve. Gjatë rishikimit të stoqeve ju keni kuptuar se Goni SHA ka një sasi domethënëse të stoqeve të pantollonave me ngjyrë portokalli me xixa. Ju besoni se e gjithë sasia e këtyre stoqeve duhet të shlyhet nga librat. Në rishikimin pasues të këtyre stoqeve keni kuptuar se pantollonat me ngjyrë portokalli me xixa, herën e fundit janë shitur para dy vitesh. Vlera totale e këtyre stoqeve është €200,000 (15% e stoqeve totale në pasqyrën e pozicionit financiar). Në diskutimet me menaxhmentin ata ju kanë bërë të qartë se nuk do të korrigojnë pasqyrat financiare pasi që besojnë se këto pantollona do të kthehen në modë së shpejti. **(4 pikë)**

(b) Shpjegoni se çka nënkupton raporti i pamodifikuar i auditimit dhe kur mund të jepet ky raport. **(5 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja

(a)

i. Ky është shembull kur 'informatat tjera' nuk janë konsistente me informatat në pasqyrat financiare. Ju keni përcaktuar se shifra në pasqyra financiare është e saktë ndërsa në raportin e menaxhmentit e pasaktë. Duhet të diskutohet me menaxhmentin për mundësinë e ndryshimit të raportit të drejtorit. Nëse menaxhmenti refuzon të korrigjojë, auditori duhet të përfshijë një paragraf shpjegues në të cilin përshkruhet jokonsistenca materiale në mes të informatave në pasqyra financiare dhe në raportin e drejtorit.

ii. Çështja e dytë ka të bëjë me pasiguri materiale. Kjo çështje ka ndikim në hipotezën e vijimësisë së kompanisë prandaj duhet të përfshihet një paragraf i theksimit të çështjes, edhe pse raporti i auditimit nuk do të rezervohej. Nga ju pritet të rishikoni shënimin shpjegues të pasqyrave financiare si dhe të identifikoni se deri ku kanë arritur diskutimet me bankën para se ju të nënshkruani raportin e auditimit.

iii. Ky është shembull i mosmarrëveshjes me menaxhmentin. Përveç nëse menaxhmenti mund të ju ofrojë dëshmi për të mbështetur deklaratimet e tyre se pantollonat do të shiten, ju duhet të rezervoni opinionin. Ky është rast i mosmarrëveshjes i cili rezulton me 'përveç për' opinion pasi që shuma është materiale mirëpo jo përhapësë.

(b) Çka nënkuptohet nga raporti parezervë

- a. Janë mbajtur regjistrat e duhur kontabël
- b. Pasqyrat financiare përputhen me regjistrat dhe librat
- c. Të gjitha informacionet dhe shpjegimet janë pranuar nga auditori
- d. Auditori ka pasur qasje të pakufizuar në libra dhe regjistra të kompanisë
- e. Janë shpalosur të gjitha informatat që është dashur të shpalosen si kërkesë e legjislacionit dhe standardeve të raportimit

Përveç kësaj, sipas SNA 700, në mënyrë që auditori të jep një opinion të pamodifikuar duhet

- Përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit nëse pëasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimeve;
- Sigurohet se nuk ka anomali të pakorrigjuara të cilat mund të jenë materiale, individualisht ose të grumbulluara. Ky vlerësim duhet të përfshijë konsiderimin e aspekteve cilësore të praktikave të kontabilitetit të entitetit, përfshirë anshmërinë nga menaxhmenti.
- Sa i përket paraqitjes së drejt dhe të sinqertë, auditori duhet të sigurohet se janë përfshirë të gjitha shënimet shpjeguese në pasqyra financiare; dhe
- Pasqyrat janë përgatitur në pajtueshmëri me standardet e zbatueshme të kontabilitetit në juridiksionin përfshirë çfardo kërkesë ligjore.

Detyra 3

(a) Ky është viti i parë i juaji si auditor i Hoga, një kompani e vogël që prodhon këpucë të cilësisë së lartë dhe i shet te dyqanet me pakicë. Hoga ka një libër të llogarive të arkëtueshme me përafërsisht 750 llogari. Një numër i këtyre llogarive të arkëtueshme është i vjetër, disa kanë saldo zero, të tjerat saldo kreditore dhe disa me siguri që duhet të shlyhen. Baza e klientëve të kompanisë është mikse. Në përgjithësi borxhet e këqija përfaqësojnë rreth 2% të totalit të llogarive të arkëtueshme dhe në të kaluarën është njohur një provision i përgjithshëm prej 1.5% përveç provizioneve specifike që ka bërë kompania. Shumica e borxheve të këqija janë nga konsumatorët e vegjël, mirëpo janë disa llogari të arkëtueshme më të mëdha që lëvizin shumë ngadalë. Vlera totale e llogarive të arkëtueshme është €750,000: 60% e të cilave përbëjnë rreth 30 llogari të mëdha të arkëtueshme dhe 40% përbëhen nga një numër i madh i llogarive të vogëla. Ju keni testuar sistemet e kontrolleve të brendshme lidhur me llogaritë e arkëtueshme dhe duket se funksionojnë si duhet. Në përvojën tuaj, përgjigjet nga konfirmimi i llogarive të arkëtueshme në këtë sektor janë pak mbi 50%.

Kërkohet:

Përshkruani punën e auditimit e cila duhet të kryhet për llogaritë e arkëtueshme dhe borxhet e këqija te Hoga. **(10 pikë)**

(b) Konfirmimi i llogarive të arkëtueshme është një metodë e dobishme për të përfutur dëshimi të auditimit lidhur me llogaritë e arkëtueshme.

Kërkohet:

Lidhur me konfirmimin e llogarive të arkëtueshme:

- (i) Diskutoni ndryshimin në mes të konfirmimit pozitiv dhe negativ;
- (ii) Përshkruani dy lloje të konfirmimit pozitiv përfshirë përparësitë dhe pengesat e secilit lloj; dhe
- (iii) Tregoni cilat zëra/elemente duhet të harmonizohen nga konfirmimet e llogarive të arkëtueshme. **(7 pikë)**

(c) Përshkruani rrezikun kryesor të auditimit lidhur me llogaritë e arkëtueshme. **(3 pikë)**

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a) Puna e auditimit që duhet të kryhet lidhur me llogaritë e arkëtueshme dhe borxhet e këqija:

(i) Pasi që mund të mbështetemi në kontrollet e brendshme, është e mundur të zvogëlohet niveli i testeve të pavarura (thelbësore) për këtë fushë.

(ii) Fokusi primar i testimit të pavarur do të jetë konfirmimi i LLA. Përgjigja prej 50% është e mjaftueshme. Duhet të konfirmohen të gjitha llogaritë e mëdha së bashku me një mostër të llogarive të vogëla që përfshijnë balansa zero dhe balansa negative (kreditore).

(iii) Për ato llogari për të cilat nuk kthehet konfirmimi duhet të kryhen procedura alternative, siç është verifikimi i pranimit të parave pas përfundimit të vitit. Në rastet kur nuk është pranuar paraja duhet të rishikohen a ka pasur fletëdërgesa, kontrata ose ndonjë formë të pagesës.

(iv) Për llogaritë e konfirmuara, çfardo ndryshimi duhet të ndiqet dhe hetohet. Duhet të jetë e qartë se edhe nëse klienti e konfirmon borxhin, kjo nuk do të thotë se ai edhe do ta paguajë atë.

(v) Provizionet për borxhet e këqija duhet të rishikohen duke u bazuar në përvojën në të kaluarën.

(vi) Duhet të kontrollohet saktësia matematikore e librit dhe të ndiqen shumat deri në pasqyra financiare.

(vii) Duhet të bëhet një rishikim i faturave dhe notave të kreditit afër fundit të vitit për të kërkuar dëshimi për provizione të paregjituara.

(viii) Procedurat analitike lidhur me moshimin e llogarive të arkëtueshme duke i krahasuar me periudhat e mëparshme si dëshmi për nevojën për provizionim të LLA.

(ix) Testimi i prerjes nëse shumat janë regjistruar në periudhën e duhur. Sales cut-off testing)

(b) Konfirmimi i llogarive të arkëtueshme

(i) Konfirmimet negative dhe pozitive

Konfirmimet negative kërkojnë përgjigje nga konsumatori vetëm nëse shuma e paraqitur në konfirmim nuk përputhet me shumën e konsumatorit.

Konfirmimet positive kërkojnë përgjigje në secilin rast.

Konfirmimet negative në përgjithësi përdoren kur mostra përbëhet nga një numër i madh i njësive me saldo të vogëla dhe në rastet kur kontrollet e brendshme janë të mira.

(ii) Konfirmimet pozitive

Jan dy lloje të konfirmimeve positive. Në llojin e parë, shuma tregohet nga klienti i auditimit dhe në konfirmim kërkohet që konsumatori të pajtohet ose jo. Nëse konsumatori nuk pajtohet me shumën, në konfirmim kërkohet që ai të shënoj shumën e saktë sipas konsumatorit.

Në llojin e dytë, nga konsumatori kërkohet që të shkruaj vet shumën që ka borxh.

Përparësia e llojit të parë është se vet konsumatori bën harmonizimin e shumave ndërsa pengesë e këtij lloji është që konsumatori mund të pajtohet me shumën nëse ajo është më e vogël se sa që gjendet në llogaritë e klientit të auditimit.

Në rastin e llojit të dytë, konsumatori mund të mos përgjigjet pasi që kërkohet me shumë punë nga ana e tij (të gjej shumën e saktë nga librat e tij).

(iii) Zërat për harmonizim

Përfshijnë: paranë, mallrat, notat e kreditit në transit dhe diferenca tjera kohore, notat e debitit, regjistrimet kontra, regjistrimet në ditar, gabime nga të dy palët – konsumatori dhe furnitori.

(c) Reziqet kryesore të auditimit lidhur me llogaritë e arkëtueshme

Pasuritë në përgjithësi kanë rrezik më të madh të mbivlerësimit se sa të nënvlerësimit. Ka rrezik që LLA mbivlerësohen përmes nënvlerësimit të provizioneve të borxheve të këqija. Nëse pasuritë mbivlerësohen, atëherë fitimet do të mbivlerësohen prandaj është joshëse të nënvlerësohen provizionet

Borxhet e këqija ndonjëherë fshehen në formë të kredit notave; edhe pse kjo nuk ka efekt në fitim, mund të ndikojë në prazantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Detyra 4

Ju jeni keni pozitën e menaxherit të auditimit në firmën e auditimit Heri & Partnerët. Njëri nga klientët tuaj, Gurët e Artë (GA), blen stoli nga diamantet nga tre prodhues të ndryshëm. Pastaj këto stoli shiten nga katër dyqanet e kompanisë. Ky është klienti i vetëm i firmës tuaj që është në industrinë e diamanteve. Ju jeni duke planifikuar të merrni pjesë në numërimin e stoqeve të GA. Stoqet janë llogaria më e madhe në pasqyrën e pozitës financiare dhe secila prej katër dyqaneve të kompanisë mban stoqe materiale të diamanteve. Për shkak të vlerës së lartë të stoqeve, të gjitha dyqanet do të vizitohen nga auditorët dhe do të numërohen stoqet. Me miratimin e drejtorëve të GA, ju keni punësuar firmën JOMO, e specializuar në vlerësimin e diamanteve të cilët gjithashtu do të jenë të pranishëm gjatë numërimit. JOMO do të verifikojnë nëse stolitë janë të punuara nga diamantet si dhe nëse mund të shiten duke konsideruar trendet e modës për këto stoli. JOMO gjithashtu do të sugjeroj, në bazë të mostrës, vlerën e njësisë specifike të stolisë. Numërimi do të bëhet nga personeli i dyqanit (në ekip nga dy persona) duke përdorur lista të paranumëruara.

Kërkohet:

- (a) Tregoni procedurat kyçe të auditimit që duhet të kryhen lidhur me numërimin e stoqeve që mbahen nga dyqanet dhe shpjegoni qëllimin e secilës procedurë. **(10 pikë)**
- (b) Vlerësoni faktorët që duhet të konsiderohen para se të vendoset nëse mund të mbështetemi në punën e vlerësuesve nga JOMO. **(5 pikë)**
- (c) Rekomandoni procedurat e auditimit që duhet të kryhen për të siguruar se stoqet e stolive janë vlerësuar si duhet. **(5 pikë)**

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a)

Procedura e auditimit	Arsyet për kryerjen e procedurës
Kryeni një rishikim të përgjithshëm të udhëzimeve për numërimin e stokeve për tu siguruar se:	Kontrolloni nëse udhëzimet e klinetit për numërimin e stokeve janë duke u ndjekur nga personeli që do të siguroj se numërimi është i plotë dhe i saktë.
Stoqet janë ndarë në seksione të duhura – psh sipas llojit të stolisë	Konfirmon rradhitjen e stokeve për të siguruar se nuk është anashkaluar asnjë artikull.
Personeli është duke numëruar në çift, njëri person numëron tjetri i regjistroj detajet.	Parandalon marrëveshjen e fshehtë dhe ofron siguri për stoqet (stolitë kanë vlerë të lartë) dhe se listat e stokeve nuk janë falsifikuar
Ka kontrole të duhura për të siguruar se secila njësi e stokut numërohet një herë.	Kontrollo për të siguruar se stoqet nuk janë numëruar dy herë
Dyqani është i mbyllur gjatë numërimit	Për tu siguruar se nuk ka huti për stoqet që janë shitur gjatë numërimit
Listat e numërimit janë të paranumëruara	Për tu siguruar se nuk ka lista të humbura të numërimit
Merrni një mostër të artikujve të stokeve që tashmë është regjistruar në listë dhe përputhenim me stokun e stolive	Për tu siguruar se stoqet e regjistruara në lista me të vërtetë ekzistojnë
Merr një mostër të stolive dhe përputhi me listat e numërimit	Për tu siguruar se të gjitha stoqet janë regjistruar – plotësia e regjistrimit
Merr një mostër të listës së numërimit, fotokopjo dhe vendose në dosjen e auditimit.	Për të kontrolluar se detajet në listat e numërimit nuk janë ndryshuar pas numërimit
Kontrollo nëse të gjitha listat e numërimit janë kthyer në kompani pas kryerjes së numërimit.	Për tu siguruar se të gjitha listat janë plota prandaj nuk ka nënvlerësim
Merrni numrin e fundit të fletpranimit dhe faturës së shitjes	Për tu siguruar se prerja është e saktë. Kontrolli pasues duhet të paraqes se të gjitha mallrat e pranuar pas numërimit të stokeve nuk janë përfshirë në llogaritë e pagueshme dhe faturat e shitjes pas numërimit të stokeve nuk janë përfshirë në shitjet e këtij viti.
Rishikoni kushtet e stolive me vlerësuesin e pavarur. Sigurohuni se nuk ka arsye që stoku të jetë i dal nga moda ose i dëmtuar.	Për të kontrolluar nëse ka stoqe të vjetëruara ose të dëmtuara - vlerësimi
Formoni një opinion lidhur me saktësinë e përgjithshme të numërimit të stokeve.	Për të konfirmuar se sasi të stokeve janë regjistruar saktë

(b) Faktorët që duhet konsideruar nëse mund të mbështetemi në punën e ekspertit

Auditori duhet të konfirmojë nëse ka nevojë për ekspert. Nuk është e qartë nëse auditori ka ekspertizën e duhur, mirëpo pasi që GA është klienti i vetëm në këtë industry, do të ishte e qartë se auditori i nvojitet ndihmë pasi që vlerësimi i diamantëve është i vështirë.

Kontrollo nëse eksperti (specialisti) ka përvojën relevante në vlerësimin e stolive të diamanteve. Si pjesë e procesit të angazhimit të ekspertit duhet të jetë edhe rishikimi i portfolit të kompanisë së vlerësimit dhe punës së mëparshme në vlerësimin e diamantëve.

Specialisti duhet të jetë anëtarë i një organizate profesionale për këtë çështje. Kjo i ndihmon auditorit të sigurohet se specialist ndjek standarde të përshtatshme të etikës.

Kontrollo nëse kompania e vlerësimit mund të ndikohet nga klienti ynë (psh janë të punësuar të BA). Në rastet e tilla specialist nuk do të ishte i pavarur dhe kështu raporti i tij nuk do të kishte vlerën e duhur.

Kontrollo nëse raporti i prodhuar ngaspecialisti lidhur me vlerësimin duket të jetë i arsyeshëm. Edhe pse auditori nuk ka klient tjerë në industrinë e diamantëve, auditori mund të bëjë krahasim të thjeshtë të çmimit dhe peshës së diamantit e cila mund të merret nga interneti ose dyqanet tjera për tu siguruar në saktësinë e shifrave të GA.

(c) Dëshmitë e auditimit

Për tu siguruar se stoqet e stolive vlerësohen saktë, auditori duhet të kryej procedurat në vijim: Stoqet duhet të vlerësohen sipas kostos ose vlerës neto të realizueshme.

- Për një mostër të stolive në listën e stoqeve, ndjek koston e tyre deri te fatura origjinale e blerjes, duke u siguruar se përshkrimi i mallit në faturë përputhet me stolitë.
- Për stolitë e shitura pas fundit të vitit, krahaso një mostër të faturave të shitjes me listën e stoqeve dhe sigurohu se çmimi i shitjes është më i lart se kosto. Në rastet kur vlera e shitjeve është më e ulët se kosto, sigurohu se stolitë janë paraqitur me vlerën e tyre të realizueshme në listën e stoqeve.
- Rishiko raportin e vlerësuesit profesionist. Sigurohu se stoqet janë të vërteta. Për zërat e kontrolluar nga vlerësuesi, përputhni vlerësimin e atij artikulli me listën e stoqeve. Nëse ka diferenca, psh për shkak të vjetërsisë së stoqeve ose për shkak të daljes nga moda, diskuto me klientin dhe pajtohuni për vlerën reale të atyre artikujve. Në këtë rast vlera e artikujve duhet të japet nga vlerësuesi profesionist In these situations, the value should be that provided by the professional valuer.
- Në rastet kur një artikull ka qenë në stoqe për një periudhë më të gjatë kohore, (psh më shumë se një vit), kontrollo raportin e vlerësuesit nëse kërkohet provizionim i duhur.

Detyra 5

Ju jeni menaxheri i auditimit në firmën e auditimit Puja & Puja. Një nga klientët tuaj të auditimit është Atleti ShPK., një kompani e cila është specializuar në prodhimin dhe shitjen e pajisjeve sportive. Atleti ShPK. ka qenë klient i auditimit për pesë vjet dhe ju keni qenë menaxheri i auditimit për tre vjetët e kaluar ndërsa partneri për auditime ka mbetur po ai që ka qenë. Tani jeni duke planifikuar auditimin për vitin që mbaron në datën 31 Dhjetor 2017. Nga takimi fillestar me drejtorët e Atleti ShPK., keni përfutur informacionet e mëposhtme.

- (i) Atleti ShPK është duke u përpjekur të regjistrohet në një nga bursat e mirënjohura të këmbimit të aksioneve dhe letrave me vlerë. Drejtorët kanë themeluar një komitet të auditimeve, ashtu si kërkohet nga rregulloret e qeverisjes së korporatës, megjithëse nuk janë ndërmarrë veprime të mëtejshme për sa i takon këtij aspekti. Informacionet që kanë të bëjnë me regjistrimin në bursë nuk janë ende të ditura publikisht.
- (ii) Juve iu është kërkuar të vazhdoni të përgatisni pasqyrat financiare të kompanisë, siç keni bërë në vitet e kaluara.
- (iii) Si auditorë të kompanisë që jeni, Atleti ShPK do të dëshironte që ju dhe partneri për auditime të merrnit pjesë në një pritje, në mbrëmjen e ardhshme në një hotel, ku Atleti ShPK do të paraqesë marrëveshjet e tyre për t'u regjistruar në bursë, ndaj bankave dhe aksionarëve të mëdhenj ekzistues.
- (iv) Atleti ShPK ka treguar se tarifatat për shërbimet tatimore që janë kryer gjatë vitit që mbaron në datën 31 Dhjetor 2016 do të paguheshin sipas autoritetit tatimor të kenë aprovuar saktësinë e detyrimeve tatimore të kompanisë. Ju i keni dhënë këshilla Atleti ShPK për sa i takon ligjshmërisë së zërave të caktuar si 'të lejueshëm' për qëllim tatimor mirëpo autoriteti tatimor është duke i kundërshtuar këto zëra. Së fundi sapo keni trashëguar, 5% të kapitalit aksionar të Atleti ShPK si trashëgimi nga vdekja e një kushëriri të largët.

Kërkohet:

(a) Identifikoni, dhe shpjegoni relevancën e të gjithë faktorëve të cilët mund të kërcënojnë pavarësinë e Puja & Puja gjatë auditimit të pasqyrave financiare të Atleti ShPK për vitin që mbaron në datën 31 Dhjetor 2017. Shpjegoni shkurtimisht mënyrën se si duhet të menaxhohet secili kërcënim.

(10 pikë)

(b) Shpjegoni veprimet që duhet të ndërmerret bordi i drejtorëve të Atleti ShPK në mënyrë që të përmbushë kërkesat për qeverisje të korporatës që Atleti ShPK të mund të regjistrohet në bursë.

(6 Pikë)

(c) Shpjegoni arsyet se pse firma e auditimit do të ketë nevojë të komunikojë me komitetin e auditimeve të Atleti ShPK për sa i takon këtij auditimi dhe auditimeve të ardhshme.

(4 Pikë)

[Totali: 20 pikë]

Zgjidhja

a) Kërcënimet ndaj pavarësisë

Qarkullimi i partnerit për auditime

Atleti sh. p. k. ka pasur të njëjtin partner për auditime për pesë vjetët e fundit. Pavarësia e partnerit për auditime mund të dëmtohet nëse një pozicion i tillë mbahet për më shumë se pesë vjet për një kompani të regjistruar në bursë. Arsyet pas kësaj janë që partneri është shumë afër drejtorëve dhe personelit në firmë dhe një gjë e tillë mund të dëmtojë gjykimin mbi pasqyrat financiare. Megjithatë, Atleti sh. p. k. aktualisht nuk është i regjistruar në bursë prandaj kjo kërkesë nuk është e aplikueshme.

Meqënëse Atleti sh. p. k. tani është i regjistruar në bursë, Puja&Puja duhet të qarkullojë partnerin për auditime këtë vit për të shmangur të gjitha kërcënimet e familjaritetit. Megjithatë, duke pasur parasysh se Atleti sh. p. k. nuk ishte një kompani e regjistruar në bursë deri sa filloi ky auditim, mund të nënkuptohet se partneri mund të vazhdojë këtë vit, por do të duhet të qarkullojë para auditimit të vitit 2017.

Përgatitja e pasqyrave financiare

Me sa duket Puja&Puja ka qenë duke përgatitur pasqyrat financiare të Atleti sh. p. k. - t duke dhënë në të njëjtën kohë shërbime të auditimit të vitet e mëparshme. Ndërsa kjo mund të mos ketë qenë një çështje që cenon pavarësinë në të kaluarën, ka shumë gjasa që të kërcënojë pavarësinë tani, për shkak se në shumicën e juridiksioneve auditorëve nuk iu lejohet të japin shërbime të tjera ndaj klientëve të tyre të auditimit, sidomos klientëve që janë të regjistruar në bursë. Përgatitja e pasqyrave financiare bashkë me auditimin e tyre do të bëjë që Puja&Puja të përballet me një kërcënim të vetë - rishikimit, gjë që do të thotë që auditorët të mos jenë të aftë të shohin gabimet, ose të mos kenë dëshirë të raportojnë gabimet në materialin që kanë përgatitur më parë vetë. Puja&Puja duhet pra të mos pranojë të përgatisë pasqyrat financiare të Atleti sh. p. k.t.

Ndjekja e ngjarjes sociale

Ndjekja e një ngjarjeje sociale që ka të bëjë me regjistrimin në bursë mund të mos jetë diçka e përshtatshme meqënëse Puja&Puja mund të shihet si dikush që mbështet Atleti sh. p. k.n në këtë sipërmarrje. Ka pra një kërcënim të mbrojtjes ndaj pavarësisë. Mbështetja për klientin mund të nënkuptojë se firma e auditimit është "shumë afër" ndaj atij klienti duke humbur në këtë mënyrë pikëpamjen e pavarur për sa i takon auditimit. Kjo është në të njëjtën kohë një kërcënim i familjaritetit. Puja&Puja duhet të pra, që me edukatë të mos pranojë të marrë pjesë në darkë, duke treguar qartazi arsyet.

Tarifat e papaguara për shërbimet për tatime

Tarifat e papaguara për shërbimet e tatimeve mund të interpretohen si një kredi e dhënë ndaj klientit të auditimit. Firmat e auditimit duhet të mos japin ose marrin kredi nga klientët e auditimit. Kreditë që nuk janë paguar ende do të kenë ndikim mbi pavarësinë meqënëse shlyerja e kredisë mund të shihet si diçka më shumë e rëndësishme se sa dhënia e një opinionit të përshtatshëm të auditimit.

Puja&Puja duhet të diskutojë përsëri situatën me Atleti sh. p. k. - n, duke i sugjeruar se duhet të paguhet e gjithë tarifa në llogarinë bankare. Në mënyrë alternative, puna e auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2017 mund të shtyhet derisa të paguhet tarifa për vitin paraardhës.

Trashëgimia

Partneri për auditime nuk ka të drejtë të mbajë aksionet e një kompanie klient. Ky provizion përfshijnë personelin e auditimit sa herë që këta të fundit përfshihen në auditime. Çështja e pavarësisë është thjeshtë ajo që aksionari (auditori në këtë rast) mund të jetë më shumë i interesuar në vlerën e aksioneve se sa në dhënien e një opinion "të saktë" mbi pasqyrat financiare.

Aksionet duhet të hiqen nga dora sa më shpejt të jetë e mundur. Megjithatë, duke pasur njohuri për regjistrimin e kompanisë në bursë, si shitja tani si shitja disa ditë më pas për të përfutur një çmim më të mirë mund të konsiderohet si "tregti duke pasur në dorë informacione të brendshme". Mund të jetë më mirë që menaxheri i auditimit të japë dorë heqjen menjëherë nga auditimi për të kufizuar të gjitha problemet aktuale ose të mundshme me pavarësinë. Auditori mund të ketë nevojë për këshilla profesionale në kohën kur shet aksionet.

(b) Përbushja e kërkesave të qeverisjes së korporatës

Për momentin, i vetmi veprim që duket se është ndërmarrë nga drejtorët është themelimi i një komiteti të auditimeve. Duke pasur parasysh se Atleti sh. p. k. do të regjistrohet në një bursë të mirënjohur, atëherë vetë kompania do të duhet të përmbushë kërkesa të tjera të qeverisjes së korporatës. Këto kërkesa përfshijnë:

- Bërja e sigurt se kryetari i bordit dhe Kryeshefi ekzekutiv i kompanisë (CEO) janë dy njerëz të ndryshëm.
- Caktimi i drejtorëve jo - ekzekutivë në bordin e Atleti sh. p. k.t. Numri i drejtorëve jo - ekzekutivë duhet të jetë i njëjtë me numrin e drejtorëve ekzekutivë minus kryetari.
- Bërja e sigurt se të paktën njëri nga drejtorët jo - ekzekutivë ka eksperiencën relevante financiare.
- Caktimi i drejtorëve jo - ekzekutivë tek komiteti i auditimeve, komiteti për kompensime dhe mundësisht tek një komitet për caktime në detyrë. Kryetari i bordit duhet në të njëjtën kohë të ketë nga një vend në të gjitha këto komitete.
- Themelimi i një departamenti të auditimit të brendshëm për të rishikuar sistemet e kontrolleve të brendshme të Atleti sh. p. k.t dhe për të bërë raportet për komitetin e auditimeve.
- Bërja e sigurt se Atleti sh. p. k. ka një sistem të përshtatshëm të kontrolleve të brendshme dhe se drejtorët janë në dijeni të përgjegjësive të tyre për themelimin dhe vënien në funksion të këtij sistemi.
- Themelimi i procedurave për të ruajtur kontaktet me aksionarët institucionalë dhe të gjithë aksionarët e tjerë kryesorë. Pritja në mbrëmje për aksionarët mund të bëhet një ngjarje e rregullt në këtë aspekt.
- Kontrolli i faktit se raportet vjetore financiare përmbajnë informacione mbi qeverisjen e korporatës ashtu siç kërkohet nga bursa e këmbimit të aksioneve dhe letrave me vlerë (p. sh. një raport mbi mënyrën se si drejtorët monitorojnë sistemet e kontrolleve të brendshme).

(c) Komunikimet me komitetin e auditimeve

Sipas shumicës së sistemeve të qeverisjes së korporatës, pika kryesore e kontaktit të auditorëve të jashtëm me një kompani është komiteti i të auditimeve. Ka disa arsye të ndryshme për një gjë të tillë:

- Së pari, për të bërë të sigurt se ruhet pavarësia midis bordit të drejtorëve dhe firmës së auditimit. Komiteti i auditimeve përbëhet nga drejtorët jo - ekzekutivë, të cilët nga përkufizimi janë të pavarur nga kompania dhe në këtë mënyrë mund të kenë një pikëpamje objektive ndaj raportit të auditimit.
- Komiteti i auditimeve do të ketë më shumë kohë për të rishikuar raportin e auditimit dhe komunikimet e tjerë ndaj kompanisë nga auditori (p. sh. deklaratimet e menaxhmentit) dhe jo ndaj bordit. Auditori do të përfitojë nga fakti se raportet e tyre do të rishikohen me kujdes.
- Komiteti i auditimeve mund të bëjë të sigurt se janë implementuar të gjitha rekomandimet nga auditorët. Komiteti i auditimeve ka drejtorë jo - ekzekutivë të pavarur të cilët mund të ushtrojnë trysni mbi bordin në mënyrë që ky i fundit të ndërmarrë veprime sipas rekomandimeve të auditorit.
- Komiteti i auditimeve në të njëjtën kohë ka më shumë kohë për të rishikuar efektivitetin dhe efikasitetin e punës së auditorëve të jashtëm se sa ka bordi. Komiteti mund pra të bëjë rekomandime për sa i takon ri - caktimit të auditorëve, ose të rekomandojë një firmë të ndryshme në qoftë se firma aktuale bëhet e pa - përshtatshme.